



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-15393 dt. 13/05 2020

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit z. Labinot Halilaj, me dt: 20.05.2020 (E mërkure) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.03.2020.
2. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.
3. Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.
4. Të ndryshme.

Drenas, 13. 05 .2020



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-030-14741 dt. 23-04-2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 20.03.2020, ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për punën në statut të Stacioni i autobusëve”, SH. A. në Drenas-Gllogoc.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 21.02.2020.
2. Propozim Vendim i Statutit për ndërmarrjen publike Lokale “Stacioni i autobusëve”, SH. A. në Drenas-Gllogoc.
3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmben dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1, në zonën e kadastrave Drenas.
4. Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësitë e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF. Pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditë. Më pas fjalën ja kaloi Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci, ku shtoi dhe një pikë të rendit të ditës: - Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësit e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës se bashku me pikën shtesë.

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk ka,

Abstenim nuk ka.

Kalojmë te pika e parë:

1. Procesverbal i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 21.02.2020. Ka diskutime rreth procesverbalit? Jo! Hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit janë 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar.

Kundër nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim Vendim i Statutit për ndërmarrjen publike Lokale “Stacioni i autobusëve”, SH. A. në Drenas-Glllogoc.

Drejtori për gjeodezi dhe kadastër Ruzhdi Lestrani ;- Sa i përket stacionit të autobusëve dhe ish-Kosova Transit në komunat tjera kjo punë ka përfunduar në vitin 2010, mirëpo ne jemi duke u munduar me e kap hapin e fundit sepse atëherë i kanë pas 264 dite përti përfunduar po nuk i kanë përfunduar. Së pari, duhet të behet statuti i kompanisë pastaj dërgohet për ligjshmëri, pasi përfundohet procedura e ligjshmërisë, tani kuvendi prapë e bënë emërtimin e bordit të drejtoreshave domethënë strukturat menaxhuese të kësaj kompanie publike lokale. Në momentin e miratimit të aprovimit të kërkesës propozimin e bënë kryetari me kuvendin pasi te përfundohen këto procedura kthehet ligjshmëria atëherë kompletohet dosja shkon për regjistrim në ARBK në momentin e regjistrimit në ARBK atëherë mundemi me quajtur se ky ka përfunduar dhe atëherë është në kuadër të komunës tonë, unë jam duke bërë përpjekje që katër muaj për me aprovua këtë procedurë sepse kjo ka shkuar në vitin 2010 dhe është dashur të kryhet ne vitin 2011 maksimumi prej atëherë deri tani kanë ndryshuar ligjet e shumë gjëra. Jemi duke bërë përpjekje maksimale me e arrit ne me bërë këtë për mos me shkuar me pag por me marrë si pasardhës, trashëgimtar të Kosova Transit për me mund mos me kalu nëpër procedura të privatizimit sepse është një kosto e madhe.

Burim Bujupi – kisha dy pyetje për anëtarin e komisionit z.Lestrani këtu ne status nuk na ka ardhë një raport se cilët janë anëtarët e tjerë të komisionit sepse ne nuk kemi informata dhe nuk e dije saktësisht se kush kanë qenë anëtarët e komisionit e dimë që i kemi votu në kuvend por tash nuk mundemi ne me i mbajt në mend dhe pse nuk e keni bërë një raport me dite se qka është diskutu me anëtarët tjerë dhe a janë të pajtimt rreth këtij statuti?

Drejtori për gjeodezi dhe kadastër Ruzhdi Lestrani- janë procesverbalet edhe raporti përfundimtar, i cili nuk është i nënshkruar për arsye të pandemisë, Anëtarët janë Petrit Gashi dhe Bujar Dervishi, pra ka qenë i nënshkruar prej tyre ajo nuk mund me u sjell është mbet për me u nënshkruar nga ata. Petriti është i pajtuar, por duhet me ardhe me nënshkruar fizikisht edhe pse ajo vlen me dy anëtar se tre anëtarë jemi krejt, nese dy e kanë nënshkruar ajo është e vlefshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-qëllimi kësaj është shume i mirë dhe në një fare mënyrë është mirë me procesu me shpejt si procedur .

Drejtori Ruzhdi Lestarni- Burimi ka të drejt që po kërkon sepse kjo është ndryshuar,ka qenë një komision tjetër, tani është një tjetër komision por arsyeshmërin e të gjitha ja dërgojmë në mënyrë elektronike për shkak të corona virusit mos me pas kontakt me gjëra fizike.

Gani Podrimqaku –a është diskutu lidhur me obligimet e Kosova Tranist sa janë obligimet se nëse e marrim ne si Komunë ndoshta ka edhe obligime mos janë obligimet shumë të medhaja?

Drejtori Ruzhdi Lestrani- Kosova Transi nuk ka obligime kaq të lira ata që e kanë pas në shfrytëzim tek minuta 7:50 nuk ndegjohët incizimi deri tek minuta 8:03

Burim Bujupi –realisht unë jam për me avancu dhe me shkuar përpara me statutin, mirëpo nuk është puna veq të ju po gjithëmonë nëpër komisione po na mungojnë raportet, jam për me përcjellë për kuvend mundësisht me qenë raporti i plotë.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Labinot Halilaj -Diskutime të tjera. Nuk ka-e rekomandoj për kuvend .

Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1,në zonën e kadastrave Drenas.

Burim Bujupi-unë mendoj që sa herë që ka propozim vendime për formimin e komisioneve është mirë që anëtarët që emrat e ekzekutivit paraprakisht me hulumtua edhe ne si anëtar të kuvendit për me dit se çfarë anëtar janë CV-ne e tyre ju kisha bërë kërkesë para se me ardh në kuvend me i ditë emrat e anëtarëve të ekzekutivit

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci –unë nuk kam përcaktua asnjë emër për ekzekutiv,por pasi po kërkon po marrim vendim sot,ti dërgoi emrat me emali ty edhe të gjithë komitetit nuk ka problem, besoj që po e dini për cilën parcelë po behët fjalë propozimi është për parcelën përtej banesave të Kullës edhe të Rukollit në atë pjesë ne duhet me ndërmarre diçka ne edhe ashtu e kemi projekt,që duhet me zhvillu atë pjesë jo me lënë në mes të sheshit në gjendje te mjerueshme atë pjesë ku edhe kanë filluar njerëzit ne pronë tonë të ndërtojnë edhe shtëpi .

Drejtori Ruzhdi Lestrani-planifikimi ka qene qe nga viti 2008 planifikimi urban planifikimi zhvillimor në vitin 2012 ka filluar një iniciativë po e kanë ndërpre dhe i kanë lanë ne gjendje të mjerueshme ata banoret aty,pra shfrytëzuesit janë te banimit të objektit jo të parcelave komunale

objekte janë të privatizara janë te tyre, komuna i ka ndërtu po ata i kanë në shfrytëzim ata i kanë privatizu në vitin 1992.

Duke pasur parasysh Planin Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale dhe Planifikimin Urban në Komunën e Drenasit, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm, në zonën kadastrale në Drenas, në parcelën 743/1, do të behët këmbimi, respektivisht shpronësimi i banesave pronë private, të cilat ndodhen në pronën e komunës së Drenasit, duke siguruar edhe qëllimin e përmbushjes së interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Parcela 743/1, në zonën kadastrale në Drenas, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal është zonë e planifikuar për ndërtim të lartë. Andaj, qëllimi i këtij komisioni është që të bëjë vlerësimin e të gjitha banesave private të cilat ndodhen në pronën komunale, e të cilat mund të këmbehen me banesat pronë komunale, në të njëjtën kohë të epen rekomandimet për banesat private të cilat në bazë të m² nuk mund të këmbehen.

Duke pasur parasysh këto që u thanë me lartë kërkoj nga ana juaj që të aprovoni këtë propozim vendim me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm në atë zonë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj –e rekomandoi për kuvend këtë pikë të rendit të ditës,dhe në mënyrë unanime votohet për seancë të kuvendit

Për votuan 7 anëtar.

Kundër nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Kalojmë te pika e katërt e rendit të ditës:4. Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësit e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci-sqaroi rreth gjendjes së përgjithshme në QKMF po ashtu edhe për ngritje të çmimeve nëpër markete të ndryshme. G jendja është nën kontroll dhe e menaxhueshme, dhe falënderoj të gjithë ata vullnetar që janë paraqitur për të bashkëpunuar me komunën Drenas në këto ditë rrezikshme nga virusi COVID19.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj: rekomandoi që edhe kjo pikë të shkojë në Kuvend për diskutim. Më pas hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Të ndryshme

Pasi nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 08 min.

Procesmbajtëse:


Zaharie Podrimqaku Subashi.


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT

Nr.01-400/01-15356 dt.13.05.2020

Në bazë të nenit 58 par. 1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozonë: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 4 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 pika 2.3, pika 2.4 dhe nënpika 2.4.3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji Nr.03/L-139), Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2020 të aprovoi këtë:

PROPOZIM -V E N D I M

Për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të ngastrave kadastrale, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervuari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat .

I.

Të APROVOHET Propozim vendimi për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik për ngastrat kadastrale në Krojkovë, për parcelat të cilat janë prona private, me nr. :

- P-70315035-00207/2,
- P-70315035-00208/4
- P-70315035-00211/4

II.

Qëllimi për shpalljen e këtyre parcelave në interesë të përgjithshëm publik është bërë me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e funksionalizimit të sistemit të ujësjellësit, në zonen kadastrale në Krojkovë, te burimi i ujit dhe rezervuari ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë edhe pompat, për të furnizuar banorët e Komunës së Drenasit me ujë të pijes, konkretisht për banorët e fshatit Krojkovë.

III.

Pronat e paluajtshme që do të shpronësohen kanë këto karakteristika: parcela kadastrale nr.207-2, me sipërfaqe prej 737 m2, e evidentuar në certifikatën e pronësisë nr. P-

70315035-00207/2, Zona kadastrale Krojkovë - Drenas, prone private- rrugë, me pronësi 1/4, me pronarë Naim Tahir Podrimqaku, Muharrem, Tahir Podrimqaku, Avdyl Tahir Podrimqaku dhe Shaban Tahir Podrimqaku.

Parcela kadastrale nr.208-4, me sipërfaqe prej 464 m², e evidentuar në çertifikatën e pronësisë nr. P-70315035-00208/4, Zona kadastrale Krojkovë – Drenas, pronë private-rrugë, me pronësi 1/4, me pronarë Naim Tahir Podrimqaku, Muharrem Tahir Podrimqaku, Avdyl Tahir Podrimqaku dhe Shaban Tahir Podrimqaku.

Parcela kadastrale nr.211-4, me sipërfaqe prej 150 m², e evidentuar në çertifikatën e pronësisë nr. P-70315035-00211/4, Zona kadastrale Krojkovë - Drenas, pronë private-livadhë i klasës së 4, me pronësi 1/1, me pronarë Shaban Tahir Podrimqaku.

IV.

Për zbatimin e këtij propozim Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicon procedurën e metejme për shpronësim të ngastrave kadastrale në Zonën Kadastrale në Krojkovë, me sip.:

- Parcela nr.207/2 me sipërfaqe prej S=737 m²
- Parcela nr.208/4 me sipërfaqe prej S=464 m²
- Parcela nr.211/4 me sipërfaqe prej S=150 m²

V.

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundojë të gjitha procedurat e nevojshme gjeodizike, kadastrale që nevojiten për shpronësimin e këtyre parcelave.

VI.

Për monitorimin e zbatimit të vendimit do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit.

VII.

Pjesë perbërëse e këtij vendimi janë:

- skica e teremit dhe
- certifikata e njësisë kadastrale.

VII.

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasit dhe konfirmimit ligjor nga MAPL në Prishtinë.

KRYETARI I KOMUNES

Ramiz Lladrovci



A r s y e t i m

Propozimi për shpalljen e këtyre parcelave në interesë të përgjithshëm publik është bërë me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e funksionalizimit të sistemit të ujësjellësit, për të furnizuar banorët e Komunës së Drenasit me ujë të pijes, konkretisht për banorët e fshatit Krojkovë.

Shpronësimi e këtyre pronave janë të domosdoshme për qytetarët e Komunës së Drenasit, që të furnizohen me ujë të pijes.

Ky burim i ujit është në prona private, dhe vetëm një pjesë është pronë shoqërore KK. Drenas, prandaj për qasjen në këtë burim të ujit, medoemos duhet të shpallën në interes të përgjithshëm-publik edhe dy parcelat me nr.207/2 me sipërfaqe prej $S=737\text{ m}^2$ dhe parcela nr.208/4 me sipërfaqe prej $S=464\text{ m}^2$, të cilat janë rrugë private, ku për mesë të këtyre rrugëve shkohet deri në vendin e burimit të ujit, aty ku janë pompat e ujit edhe rezervuari, të cilat janë në parcelen nr.211/4 me sipërfaqe prej $S=150\text{ m}^2$

Ekipi profesional i Drejtoratit për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë ka dal në vendshiqim dhe janë përcaktuar për inqizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuar më lartë të cilat do të shpronësohen, për të cilat pjesë edhe janë nxjerrë edhe skicat grafike dhe certifikatat mbi të drejtat e pronës.

Pas miratimit të këtijë Propozim-Vendim Komuna- kryetari i komunës inicon procedurën e shpronësimit të pronës - paluajtshmerisë së shënuar më lartë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Të bashkangjitur e keni skicen e terenit dhe certifikaten e njësisë kadastrale.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTARTVO INFRASTRUKTURE I SRREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315035-00211-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 10-030-73859
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 12.05.2020 - 15:33
Komuna / Opština / Municipality: Glogoc / Glogovac / Glogoc
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone: KRAJKOVË / KRAJKOVO / KRAJKOVË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: Glogoc / Glogovac / Glogoc

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Caq. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315035-00211-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Rural	150			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KRONI- NER SHPI/KRONI- NER SHPI/KRONI- NER SHPI		KRONI- NER SHPI		



A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numri Brot Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Livadhë/Livade/meadow	Livadh I Klasës 4/Livada4 Klase/4th Class Meadow	150

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. person Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postai Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Početnosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individuelna Drazvina / single possessor	PODRIMQAKU SHABAN (TAHIR)	1030222292	///			1/1		



F. Shagjiri



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315035-00208-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 10-030-73859
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 12.05.2020 - 15:35
Komuna / Opština / Municipality: Glllogoc / Gllgovac / Glllogoc
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: KRAJKOVË / KRAJKOVO / KRAJKOVË
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Glllogoc / Gllgovac / Glllogoc

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315035-00208-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Rural	464			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KRONI-NER SHPI/KRONI-NER SHPI/KRONI-NER SHPI		KRONI-NER SHPI		



A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numri i Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë/Pu/ Road		464

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Bashkë Posëdim / SuDrzavina / co-possessor	PODRIMQAKU NAIM (TAHIR)	1002099167	KRAJKOVË / KRAJKOVO / KRAJKOVË /			1/4		
Bashkë Posëdim / SuDrzavina / co-possessor	PODRIMQAKU MUHARREM (TAHIR)	KCID914121546	KRAJKOVË / KRAJKOVO / KRAJKOVË /			1/4		
Bashkë Posëdim / SuDrzavina / co-possessor	PODRIMQAKU AVDYLL (TAHIR)	1030222284	KRAJKOVË / KRAJKOVO / KRAJKOVË /			1/4		
Bashkë Posëdim / SuDrzavina / co-possessor	PODRIMQAKU SHABAN (TAHIR)	1030222292	///			1/4		



F. Shagiti
2 / 2



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRATVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315035-00207-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 10-030-73859
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 12.05.2020 - 15:34
Komuna / Opština / Municipality: Glogoc / Glogovac / Glogoc
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: KRAJKOVË / KRAJKOVO / KRAJKOVË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Glogoc / Glogovac / Glogoc

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315035-00207-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land	Rural	737	0003-84		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KRONI-KOD KUQE/KRONI-KOD KUQE/KRONI-KOD KUQE		KRONI-KOD KUQE		



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²) (m²) (m²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë/Pu/Road		737

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Bashkë Posedim / SuDzavina / co-possessor	PODRIMQAKU NAIM (TAHIR)	1002099167	KRAJKOVË/ KRAJKOVO/ KRAJKOVË/			1/4		
Bashkë Posedim / SuDzavina / co-possessor	PODRIMQAKU MUHARREM (TAHIR)	KCID914121546	KRAJKOVË/ KRAJKOVO/ KRAJKOVË/			1/4		
Bashkë Posedim / SuDzavina / co-possessor	PODRIMQAKU AVDYL (TAHIR)	1030222284	KRAJKOVË/ KRAJKOVO/ KRAJKOVË/			1/4		
Bashkë Posedim / SuDzavina / co-possessor	PODRIMQAKU SHABAN (TAHIR)	1030222292	///			1/4		




Fatmir Shagiri
2021



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë



SKICA E TERENIT



Ne ket skic te terenit eshte e paraqitur siperfaqja e llogaritur neper secilen parcell veq e veq, dhe gjersija e kesaj rruge eshte e llogaritur prej 5.0m, ndersa pjesa e bazenit eshte i shtrire ne dy ngastra dhe eshte e shenuar ne skice siperfaqet .

Punoj : Baki Fetahu





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë



SKICA E TERENIT



Ne këtë skicë të terrenit është e paraqitur sipërfaqja e llogaritur nëpër secilin parcelë veç e veç, dhe gjersija e kësaj rruge është e llogaritur prej 5.0m, ndërsa pjesa e bazenit është e shprehur në dy ngastra dhe është e shënuar në skicë sipërfaqet.

Punoi : Baki Fetahu

